



EMRI MBIEMRI



1. Plotëso fjalitë me fjalët e dhëna: bashkëbiseduesit, dikujt, kujt, folësit.

Përemri pronor tregon se _____ i përket prona.

Përemri pronor i vetës së parë tregon se sendi i përket _____ ose një grupi ku bën pjesë edhe _____: libri im, libri ynë.

Përemri pronor i vetës së dytë tregon se sendi i përket _____ ose një grupi ku bën pjesë edhe _____: topi yt, topi juaj.

Përemri pronor i vetës së tretë tregon se sendi i përket _____ që nuk është i pranishëm në bisedë: makina e tij, makina e tyre.

2. Vendos përemra pronorë pranë emrave të dhënë.

Unë	kuleta _____	veshjet _____
Ti	fleta _____	macet _____
Ai	djali _____	librat _____
Ajo	qyteti _____	pantallonat _____
Ne	makina _____	shkollat _____
Ju	lulja _____	tregimet _____
Ata	pallati _____	shkrimi _____



3.Zëvendëso emrin e nënvizuar me një përemër pronor.

Tezja **e Rejanit** është mjeke. _____

Djali **i hallës** është i vogël. _____

Rrugët **e qyteteve** janë të gjera. _____

Emrat **e nxënësve** janë të ndryshëm. _____

4. Lidh përemrat pronorë me përemrat vetorë.

ti	i tij
ai	e tyre
ju	yt
ato	ime
ne	tanë
unë	tuaj

5.Përcakto vetën, gjininë dhe numrin e përemrave pronorë. (p.sh.V.UNË,GJ.F,NR.NJ)

libri im _____	fletoret e tua _____
fustani yt _____	djemtë e saj _____
lapsat tuaj _____	shoku ynë _____
lulja e tij _____	nxënësit tanë _____



**6. Shkruaj formën e saktë të përmrave
pronorë.(vetëm përmrin pronor)**

shkolla e ime _____

çanta e juaj _____

atdheu jot _____

bluza e saja _____

flamuri tonë _____

klasa e tyrja _____

SUKSESE!